

UNMIK/DIR/2000/24
21 shtator 2000

URDHËRESË ADMINISTRATIVE NR. 2000/24

PËR NDRYSHIMIN E URDHËRESËS ADMINISTRATIVE TË UNMIK-UT NR. 2000, TË NDRYSHUAR, PËR ZBATIMIN E RREGULLORES NR. 2000/03 MBI TATIMIN NË QARKULLIM NË KOSOVË TË 22 JANARIT 2000

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë me nenin 6 të Rregullores nr. 2000/3 të 22 janarit 2000 mbi Tatimin në Qarkullim në Kosovë të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK),

Pas shpalljes së Urdhëresës administrative të UNMIK-ut nr. 2000/02 të 22 janarit 2000 për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/3 si dhe të Urdhëresës administrative të UNMIK-ut nr. 2000/20 të 21 gushtit 2000 për ndryshimin e Urdhëresës administrative të UNMIK-ut nr. 2000/02,

Përderisa neni 1.1 (a) i Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut nr. 2000/02, të ndryshuar, përcakton se tatimi në qarkullim nuk u ngarkohet kategorive të mallrave të renditura në Shtojcën A,

Me qëllim të ndryshimit të Shtojcës A të Urdhëresës administrative të UNMIK-ut nr. 2000/02, të ndryshuar,

Nxjerr Urdhëresën e mëposhtme administrative,

Neni 1
Ndryshimi

Shtojca A e Urdhëresës administrative të UNMIK-ut nr. 2000/02, të ndryshuar, zëvendësohet me Shtojcën A të kësaj Urdhërese administrative.

Neni 2
Hyrja në fuqi

Kjo Urdhëresë administrative hyn në fuqi më 21 shtator 2000.

Bernard Kouchner
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm

SHTOJCA A
KATEGORITË E MALLRAVE

1. Prodhimet farmaceutike
2. Instrumentet dhe aparaturat mjekësore dhe kirurgjike
3. Qumështi*
4. Vaji dhe yndyrnat për ngrënie*
5. Perimet**
6. Pemët**
7. Mielli i grurit**

* Ky lirim nga tatimi pushon së vlejture më 21 tetor 2000.

** Ky lirim nga tatimi pushon së vlejture më 1 qershor 2001.